

## Lista Emërore e Zyrtarëve që Mbartin Detyrimin Për Deklarim Të Interesave Private.

	<b>Anduel Xhindi</b>	<b>Mbarime Isufaj</b>	<b>Vend Vakant</b>
<b>Institucioni</b>	Prefekti i Qarkut Fier	Prefekti i Qarkut Fier Nënprefektura Mallakastër	Prefekti i Qarkut Fier Nënprefektura Lushnje
<b>Funksioni</b>	Prefekt	Nënprefekt	-
<b>Arsimi/Kualifikimet.</b>	<p><b>Z.</b> Anduel Xhindi ka lindur më 25.11.1987.</p> <p>Tetor 2022 – e në vijim Master Shkencor në “Ekonomi Biznes” Fakulteti i Biznesit; Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.</p> <p>Tetor 2017 – Nëntor 2020 Diplomë Master i Shkencave në “E drejtë Publike” Universiteti i Tiranës.</p> <p>Tetor 2017 TTDiplomë Bachelor në “Financë” DD Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.</p>	<p>Ka përfunduar studimet e larta, Bachelor në Ciklin e Ulët Parashkollor. Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali Vlorë”.</p>	-

<p><b>Eksperienca në punë</b></p>	<p>08 Tetor 2025 dhe në vazhdim Prefekt I Qarkut Fier</p> <p>Dhjetor 2024- 08 Tetor 2025 Drejtore i Task Forcës në Agjencinë Kombëtare të Ujës- jellës-Kanalizimeve (AKUK).</p> <p>Tetor 2023-dhjetor 2024 Administrator i shoqërisë“Illyrian Guard”.</p> <p>Shtator 2017 – Shtator 2021 Deputet i qarkut Fier</p> <p>Nëntor 2013 – Shtator 2017 Deputet i qarkut Fier</p> <p>Nëntor 2011 – Shtator 2013 Deputet I qarkut Fier</p>		
<p><b>Paga Bruto</b></p>	<p>205 000 lek</p>	<p>170 000 lek</p>	<p>-</p>

Kompetencat dhe detyrat e Prefektit dhe Nënprefektëve të Qarkut janë të përcaktuara në nenin 8 dhe 22 të Ligjit Nr.107/2016  
“Për prefektin e Qarkut”,

## **PREFEKTI**

Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

- a) verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- b) bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që veprojnë në qark si dhe të këtyre degëve me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- c) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që veprojnë në qark, sipas urdhrit të Kryeministrit, dhe, për probleme të veçanta, sipas urdhrit të ministrit;
- ç) informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku;
- d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;
- dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;
- e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;
- ë) drejtimin ose pjesëmarrjen në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- f) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit; g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;
- gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;
- h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;

i) bashkërendimin e punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor;

j) ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore.

### **NËNPREFEKTI**

1. Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët. Prefekti propozon caktimin e funksionit të nënprefektit për një ose më shumë bashki, në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

2. Nënprefekti emërohet apo lirohet, me propozim të prefektit të qarkut, nga ministri.

3. Nënprefekti për veprimtarinë e vet, për bashkinë/bashkitë përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut.

4. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve.